



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal/Ministarstvo Administracije Lokalne
Samouprave/Ministry of Local Government Administration*

DRAFT- KONCEPT DOKUMENTI

**PËR HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT PËR
KRYEQYTETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS/PRISHTINËN**

Prishtinë, Mars 2015

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor	5
3. Synimet dhe objektivat.....	7
4. Opsionet	8
5. Përmbledhje e opsioneve	10
6. Analiza e opsioneve.....	11
7. Konsultimi.....	14
8. Krahasimi i opsioneve	14
9. Rekomandimi	15
10. Komunikimi.....	15

Kapitulli I - Hyrje

Përmes këtij koncept dokumenti për Ligjin e Kryeqytetit e Republikës së Kosovës/Prishtinën pasqyrohen sfidat, problemet dhe ngeçjet që duhet gjetur zgjidhje. Para së gjithash koncept dokumenti vjen si nevojë e rregullimit të statusit dhe organizimit të kryeqytetit në bazë të provizioneve të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.¹

Hartimi i Koncept Dokumentit për Projektligjin e Kryeqytetit të Republikës së Kosovës Prishtinës është parapa edhe në Planin e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe është njëra ndër obligimet me prioritet të lartë. ²Në dokument trajtohen aspektet e përgjithshme siç janë, definimi i problemit, çështjet që duhet të adresojë koncept dokumenti, objektivat, subjektiviteti, struktura, organizim, kompetencat si dhe burimet e financimit.

Për faktin se aktualisht Prishtina përballet me probleme me të cilat nuk përballen komunat tjera, nxjerrja e ligjit të veçantë për Kryeqytetin do të mundësonte ndryshimin e kësaj gjendje në të mirë të Prishtinës, qytetarëve të saj, si dhe të gjithë atyre që jetojnë apo veprojnë në Prishtinë pa dallim se a bëhet fjalë për qytetarë të përhershëm apo jo. Kjo për faktin se Komuna e Prishtinës në rolin e Kryeqendrës mbulon një game të gjerë të shërbimeve, i shërben një numri të madh të banorëve në krahasim me komunat (qytetet) tjera, ka një përqendrim më të madh të qytetarëve i cili shpesh reflektohet si mbingarkesë që dëmton cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve, ngarkon administratën në të gjitha segmentet e saj, e sforcon infrastrukturën urbane.

Më specifikisht, struktura dhe organizimi aktual i Komunës së Prishtinës nuk janë në gjendje t'i bëjnë ballë ofrimit të shërbimeve publike marr për bazë trendin e rritjes së numrit të popullsisë. Kur jemi të financat lokale, Komuna e Prishtinës ballafaqohet me kufizime ligjore dhe administrative të cilat e pengojnë në menaxhimin efikas të mbledhjes dhe shpenzimit të mjeteve, e në këtë mënyrë dëmtojnë edhe kapacitetin qeverisës në arritje të objektivave programore dhe strategjike.

Mënyra e organizimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore dhe atyre profesionale nuk i mundëson Prishtinës fleksibilitet dhe parakushte të nevojshme për kryerje të detyrave në mënyrë efikase, e kjo në fakt e dëmton edhe kapacitetin e saj në ofrim të shërbimeve të qëndrueshme.

Menaxhimi i sektorëve specifik që në mënyrë direkt ofrojnë shërbime shtesë për qytetarët e Republikës së Kosovës pa dallim, dhe jo vetëm për qytetarët e Prishtinës, vazhdon të sfidojë qeverisjen efikase dhe arritjen e standardeve të nevojshme. Një problem në vetë janë menaxhimi i ndërmarrjeve publike, qofshin ato komunale apo regjionale. Të parat ballafaqohen me një seri procedurash të cilat kufizojnë lirinë e Prishtinës të themelojë dhe funksionalizojë ndërmarrje komunale të cilat do të ofronin shërbime më cilësore, efikase, dhe më çmime konkurrenente. Ndërkaq sa i përket atyre regjionale, Prishtina është një aksionar i madh, por një hisedar i barabartë më komunat tjera. Kjo e vendos Prishtinën në një pozicion jo të favorshëm përballë

¹ Neni 13 Kushtetutës së Republikës së Kosovës

² Plani i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2015

qytetarëve të saj, të cilët në baza ditore kërkojnë shërbime nga komuna, dhe e njohin për autoritet të vetëm komunën të cilën e mbajnë përgjegjëse në rast të mos përmbushjes së pritjeve.

Si shembull i radhës, le të përmendim ofrimin e shërbimeve shëndetësore sekondare ku kemi Qendrën Klinike Universitare të mbingarkuar dhe e cila nuk është e projektuar të ofrojë shërbime vetëm për qytetarët e Prishtinës ose regionit, përderisa qytetarët e Prishtinës shprehin pakënaqësi në lidhje me trajtimin e tyre shëndetësor.

Kur jemi të siguria, Prishtina ballafaqohet me një numër të madh të nevojave për përkrahje në zbatimin e vendimeve dhe akteve komunale. Kjo në të shumtën e rasteve e mbingarkon punën e Policisë së Kosovës në ofrimin e shërbimeve po aq efikase sa edhe në komunat tjera.

Në lidhje me shërbimet emergjente, bie fjala ai i zjarrfikësve, Prishtina gjendet në mes nevojës për shërbime dhe menaxhimit me këto shërbime dhe për pasojë nuk ofron shërbim efikas, për çka rrezikohet jeta e qytetarëve.

Krejt në fund Prishtina në mungesë të grandit shtesë nuk ka kapacitet, as kapacitet financiar e as administrativ për të ofruar shërbime në rolin e qendrës kryesore administrative, diplomatike, ekonomike, universitare dhe për më tepër për banorët jo rezident dhe vizitorët. Këto probleme dhe sfida e bëjnë gjendjen dhe kontekstin e Prishtinës të veçantë dhe të dallueshëm nga Komunitat (qytetet) tjera të Republikës së Kosovës, duke imponuar kështu nxjerrjen e ligjit të veçantë për kryeqytetin duke definuar statusin dhe organizimin e veçantë, ashtu siç parasheh Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Ky dokument është një kontribut që reflekton nevojën e fuqizimit të qeverisjes së mirë rritjes së efikasitetit administrative, profesionale dhe teknike për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët. Ndërkaq, hartimi i projektligjit për kryeqytetin duhet t'i shërbejë qëllimit që të ofrojë zgjidhje rreth problemeve specifike që ka Prishtina si kryeqendër, si dhe opsione për administrim më të mirë.

Koncepti dokumenti duhet të reflektojë gjetjet dhe rekomandimet, sfidat e organizimit strategjik dhe administrativ të kryeqytetit, si dhe përvojat më të mira të vendeve të rajonit dhe Bashkimit Evropian që kanë kaluar nëpër sfida të ngjashme.

Qëllimi dhe përgatitja e këtij koncepti dokumenti:

Ky Koncepti dokumenti është rezultat i një vlerësimi cilësor, që pasqyron gjetjet, me të cilat ofrohet kontribut në procesin e përgatitjes së Koncepti dokumentit për Ligjin për Kryeqytetin. Si i tillë ky dokument shtjellon më hollësisht:

- Synimin që ligji të reflektojë nevojat dhe kërkesat e kryeqytetit;
- Informacionet, të dhënat dhe gjetjet e hulumtimit, bazuar në ekspertizën profesionale;
- Analizën e dokumenteve relevante, siç janë: politikat, legjislacioni, vlerësimet, raportet qeveritare dhe jo qeveritare;

- Praktikrat dhe modelet rajonale dhe evropiane;
- Aspektet e përgjithshme dhe specifike të kontekstit aktual, që ndikojnë në këtë proces.

Kapitulli II – Përshkrimi dhe definimi i çështjes

Aktualisht organizimi dhe funksionimi i Komunës së Prishtinës në mungesë të Ligjit për Kryeqytetin qeveriset përmes Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale i cili është bazë për funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës.³ Mirëpo, konform aktit më të lartë, Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht Nenit 13, Republika e Kosovës obligon institucionet e saj që me legjislacion të veçantë ta definojnë Prishtinën si kryeqytet. Ligji për Kryeqytetin (Prishtinën) është kategori kushtetuese që duhet nxjerr me qëllim të zbatimit të Kushtetutës, e cila është në fuqi pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës në shkurt të vitit 2008.

1. Në rrethanat aktuale qeverisëse në Kosovë, procesi i kompletimit të kornizës ligjore të sistemit të qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, mund të konsiderohet i përmbyllur pas miratimit të ligji të veçantë të Kryeqytetit. Ligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën duhet që medoemos të trajtojë aspekte specifike që i mundësojnë Prishtinës të funksionojë si kryeqytet i Republikës. Ligji për kryeqytetin duhet ta definojë statusin dhe organizimin e veçantë të Kryeqytetit, duke përfshirë kompetencat, organet, financat, bashkëpunimin e brendshëm urban dhe rural, bashkëpunimin me komunat fqinje, si dhe marrëdhëniet ndërmjet Kryeqytetit dhe Institucioneve shtetërore në aspektin ligjor dhe organizativ, duke i saktësuar përgjegjësitë institucionale dhe kompetencat që duhet t'i atribuohen, për t'i mundësuar Prishtinës funksionalitet dhe efikasitet të plotë.
2. Është me rëndësi t'i referohemi zhvillimeve të fundit në hapësirën evropiane, të cilat konfirmojnë trendin sipas të cilit, kryeqytetet e vendeve evropiane duhet të kenë një rol të veçantë qeverisëse dhe zhvillimor, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë nevojave të qytetarëve në ofrimin e shërbimeve publike. Në këtë frymë, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Regjionale i Këshillit të Evropës, në rekomandimet e vitit 2007 thekson se kryeqytetet, si komuna me rol të theksuar në shumicën e vendeve, duhet të kenë të drejtën të vetë-qeverisën dhe të ushtrojnë përgjegjësitë publike nga autoritete të themeluara demokratike, në përputhje me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokal.⁴ Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale parasheh të drejtën dhe kapacitetin e komunave për të rregulluar një pjesë të çështjeve publike në nivel lokal, brenda ligjit dhe me përgjegjësinë e tyre, për të mirën e qytetarëve të tyre.
3. Megjithatë para aprovimit përfundimtar të këtij Koncept dokumenti, është e nevojshme konsultimi i një spektri të gjerë të aktereve që mbulojnë vetë-qeverisjen lokale, duke

³ Ligji për Vetëqeverisje Lokale

⁴ Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale

përfshirë institucionet shtetërore, institucionet publike si dhe organizatat e shoqërisë civile veçanërisht ato që janë të specializuar në fushën e vetëqeverisjes lokale.

Politika aktuale

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 13 ka përcaktuar se Kryeqyteti i Republikës së Kosovës është Prishtina dhe se statuti dhe organizimi i Kryeqytetit do të rregullohet me ligj të veçantë. Po ashtu edhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale si ligj bazik për organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale ka paraparë që qyteti i Prishtinës si Kryeqytet i Republikës se Kosovës do të qeveriset përmes një ligji të veçantë për qytetin e Prishtinës. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale në provizionet e tij ligjore ka përcaktuar se vetëqeverisja lokale do të zbatohet për qytetin e Prishtinës deri sa të ketë legjislacion të veçantë për qytetin e Prishtinës.

Legjislacioni bazë që rregullon vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës;

1. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040;
2. Ligji për Kufijtë Administrativ te Komunave Nr. 03/L-041;
3. Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr .03/L-049;
4. Ligji për Zgjedhjet Lokale ne Republikën e Kosovës Nr. 03/L-072;
5. Ligji për Bashkëpunimin Ndër-komunal;
6. Ligjet sektoriale që ndërlidhen me kompetencat vetanake dhe kompetencat e deleguara të komunave si dhe;
7. Aktet nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve.

Shpenzimet aktuale

Kjo tabelë pasqyron shpenzimet aktuale të Komunës së Prishtinës bazuar në legjislacionin për menaxhimin financiar.

<i>Kategoritë e shpenzimeve</i>	<i>Shpenzimet faktike në vitin paraprak 2014</i>	<i>Buxheti këtë vit 2015</i>	<i>KASH për vitin e ardhshëm</i>
<i>Buxheti i Komunës:</i>	<i>Paga dhe mëditje- 25,610,136.97</i>	<i>Paga dhe mëditje- 27,050,000.00</i>	<i>Nuk është finalizuar ende</i>
<i>(Shëno secilin lloj të</i>	<i>Mallra & shërbime- 7,825,433.96</i>	<i>Mallra & shërbime- 7,385,405.00</i>	

<i>shpenzimeve)</i>	<i>Shpenzime komunale-</i> 1,609,849.09	<i>Shpenzime komunale-</i> 1,793,000.00	KASH-i 2016- 2018
	<i>Subvoenc. & transfere-</i> 4,791,642.64	<i>Subvoenc. & transfere-</i> 2,210,000.00	
	<i>Shpenzime kapitale-</i> 16,901,466.76	<i>Shpenzime kapitale-</i> 24,268,351.00	
	<i>Totali-</i> 56,738,709.42	<i>Totali-</i> 62,706,756.00	
<i>Buxhetet tjera: (Shëno secilin lloj të shpenzimit)</i>	0.00	0.00	
<i>Financimi nga donatorët, nga linja mallra, shërbime, paga e mëditje dhe investime kapitale</i>	<i>Mallra & shërbime-</i> 47,447.80	<i>Mallra & shërbime-</i> 300,251.82	
	<i>Shpenzime kapitale-</i> 15,050.00	<i>Shpenzime kapitale-</i> 49,869.62	
	<i>Totali-</i> 62,497.80	<i>Totali-</i> 350,121.44	
<i>Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave</i>	0.00	0.00	

Kapitulli III - Synimi dhe Objektivat

Synimi

Ky koncept dokument synon të trajtoj çështjet kryesore që ndërlidhen me hartimin e Ligjit të veçantë për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën. Në mungesë të rregullimit të saj si kryeqytet, Prishtina vazhdon të funksionojë ngjashëm me të gjitha komunat tjera. Kjo mënyrë e funksionimit nuk i mundëson Prishtinës adresimin efikas të objektivave dhe sfidave. Ligji për kryeqytetin duhet të marrë në konsideratë jo vetëm problemet e qytetarëve të Prishtinës, por njëkohësisht duhet të sigurojë shërbime efikase për institucionet shtetërore, banorët jo rezidentë, organizatat ndërkombëtare dhe për shumë palë tjera me qëndrim jo të përherëshëm në Prishtinë.

Objektivat

Në lidhje me këtë, Ligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën duhet definoj objektivat që kryesisht ndërlidhen me:

- Statusin dhe Organizimin e brendshëm;
- Kompetencat;
- Financimin;
- Marrëdhëniet me institucionet shtetërore;
- Bashkëpunimin me komunat fqinje.

Kapitulli IV - Opsionet

Janë tri opsione kryesore të cilat i kemi në procesin e nxjerrjes së ligjit të ri për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës – Prishtinës. Opsioni i parë, ruajtja e status quo-së (asnjë ndryshim). Opsioni i dytë, nxjerrja e ligjit të ri, Opsioni i tretë, ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit (opsioni i rekomanduar).

Opsioni i parë

Mos nxjerrja e ligjit të veçantë për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës – Prishtinën i paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ka këto efekte:

1. Ndikon në organizimin jo të qëndrueshëm të organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale në territorin administrativ të Prishtinës;
2. Ndikon në ofrim jo të qëndrueshëm të shërbimeve publike komunale që bien në kompetencë të njësive të vetëqeverisjes lokale;
3. Ndikon në zhvillim jo të qëndrueshëm të planifikimit hapësinorë, zhvillimit jo të qëndrueshëm ekonomik lokal, shëndetësisë publike, arsimit para fillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shërbime sociale, etj.

Opsioni i dytë

Nxjerrja e projektligjit të ri për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës – Prishtinën me plotësime të pranuar nga Komisioni i Kuvendit pas aprovimit të Projektligjit më herët nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka këto efekte:

1. Definojnë statusin dhe organizimin e veçantë të Kryeqytetit të Republikës në territorin administrativ të Prishtinës;
2. Ndikon në dekoncentrim të ofrimit të shërbimeve publike bazuar në kërkesat të cilat pranohen nga qytetarët e përhershëm dhe jo të përhershëm të Prishtinës, Institucionet shtetërore dhe institucionet ndërkombëtare që janë të vendosura në Prishtinë si dhe persona juridik dhe fizikë që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të Prishtinës.
3. Ndikon në zhvillim të qëndrueshëm të planifikimit hapësinor, zhvillimit ekonomik lokale, shëndetësisë publike primare dhe sekondare.

Opsioni i tretë

Opsioni i rekomanduar ose ndryshimi i qasjes ekzistuese të organizimit dhe funksionimit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës e rregulluar me ligj ndërlihet me disa pika kryesore:

1. E para, statusi dhe organizimi i veçantë i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës Prishtinës do të krijoj bazë të qëndrueshme ligjore të funksionimit dhe ushtrimit të kompetencave shtesë të Kryeqytetit në raport me njësitë tjera të vetëqeverisjes lokale, duke ruajtur sistemin një shkallësh të vetëqeverisjes lokale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ashtu siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu zbatimi i opsionit të rekomanduar definon adresën e qartë të përgjegjësisë jo vetëm për qytetarët e përhershëm të Prishtinës por edhe për qytetarët që janë të vendosur përkohësisht ose pranojnë shërbime nga organet aktuale të komunës. Vlen të theksohet se në mungesë të këtij ligji, në kuadër të fushëveprimit aktual Komuna e Prishtinës nuk mund t'iu përgjigjet kërkesave, siç bëjnë kryeqendrat tjera të shteteve të rajonit dhe më gjerë.
2. E dyta, ofrimi i shërbimeve publike shtesë nga organet e Kryeqytetit, si kryeqendër administrative, diplomatike, arsimore, shëndetësore, sociale, urbanistike, bankare, etj, do të ndikojë në rritjen e efikasitetit dhe zgjerimit të shërbimeve cilësore për qytetarët si dhe institucionet shtetërore, institucionet publike, institucionet ndërkombëtar si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që veprojnë brenda territorit të Prishtinës.
3. E treta, planifikimi i qëndrueshëm strategjik në fushën e ofrimit të shërbimeve publike, planifikimit hapësinor, arsimimit, kulturës, zhvillimit ekonomik lokal, transportit, shëndetësisë, qëndrueshmërisë financiare si dhe sigurisë publike do të ndikonte në avancimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale në ofrimin e shërbimeve bazuar në kërkesat e pranuar nga qytetarët e Prishtinës, institucionet si dhe grupeve tjera të interesit që veprojnë brenda territorit administrativ të Kryeqytetit.
4. E katërta, marr parasysh kompleksitetin e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndërinstitucional në mes të organeve lokale të Kryeqytetit dhe organeve shtetërore është e rëndësishë së veçantë që me Ligjin për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës Prishtinën, të rregullohen marrëdhëniet ndërmjet qeverisë qendrore dhe lokale në raport me ushtrimin e kompetencave, financimin, menaxhimin e pronës si dhe mbikëqyrjen ligjore.

Është e rëndësishme të potencohet se opsioni i rekomanduar është nxjerrja e Ligjit të veçantë që definon statusin dhe organizimin e veçantë të Kryeqytetit dhe i cili ligj është ligj special dhe ka epërsi në raport me ligjet tjera që ndikojnë në organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

Kapitulli V - Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Ruajtja e gjendjes ekzistuese që nënkupton mos ndryshimin e gjendjes aktuale organizimit dhe funksionimit të Prishtinës.	Plotësimi dhe ndryshimi i Projektligjit të rikthyer nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.	Nxjerrja e Ligjit të veçantë për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje lokale ndikon në organizim dhe funksionim të qëndrueshëm të Prishtinës marr parasysh specifikat.
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar	208,230.00 qytetarë të përhershëm si dhe një numër i konsiderueshëm i qytetarëve jo të përhershëm që jetojnë dhe veprojnë në Prishtinë	208,230.00 qytetarë të përhershëm si dhe një numër i konsiderueshëm i qytetarëve jo të përhershëm që jetojnë dhe veprojnë në Prishtinë.	208,230.00 qytetarë të përhershëm si dhe një numër i konsiderueshëm i qytetarëve jo të përhershëm që jetojnë dhe veprojnë në Prishtinë.
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	Organet Lokale dhe Organet Qendrore, qytetarët dhe grupet tjera të interesit	Organet Lokale dhe Organet Qendrore, qytetarët dhe grupet tjera të interesit	Organet Lokale dhe Organet Qendrore, qytetarët dhe grupet tjera të interesit
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	Organet Komunale të Komunës së Prishtinës	Organet e Kryeqytetit të Republikës së Kosovës/Prishtinës	Organet e Kryeqytetit të Republikës së Kosovës/Prishtinës
Ligjet, aktet nënligjore,	Ligji për	Plotësim	Ligji për

ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Vetëqeverisje Lokale.	Ndryshimi i Ligjit për Qytetin e Prishtinës.	Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/ Prishtinës
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat			
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Takime me grupet e interesit.	Parashihet fushatë informuese	Parashihet fushatë promovuese, dhe edukuese.
Udhëzimet dhe kodet	Legjislacioni aktual për vetëqeverisje Lokale.	Kushtetutën e Republikës së Kosovës	Në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni	Është në fuqi	Janar 2016	Janar 2016

Kapitulli VI - Analiza e opsioneve

Opsioni i parë, trajton Prishtinën si njësi e vetëqeverisjes lokale e barabartë me të gjitha njësitë tjera të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, kjo ndikon në organizim jo të qëndrueshëm dhe funksional marr për bazë specifikat. Ky opsion po ashtu ndikon në moszbatim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila shprehimisht ka përcaktuar se statusi dhe organizimi i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës rregullohet me ligj të veçantë. Aktualisht, bazuar në kompetencat ligjore, organet e komunës kanë ofruar shërbimet e domosdoshme publike për qytetarë, institucione shtetëror dhe publike dhe grupe tjera të interesit. Opsioni i parë nuk ka kosto financiare shtesë ashtu siç është përcaktuar në tabelën për Përmbledhjen e Ndikimit Financiar, mirëpo nuk siguron zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe financiare të Prishtinës.

Opsioni i dytë, trajton Prishtinën si njësi të vetëqeverisjes lokale me status dhe organizim të veçantë brenda territorit administrativ aktual Komunës së Prishtinës ashtu siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ndikon në dekoncentrim të ofrimit të shërbimeve publike bazuar në kërkesat të cilat pranohen nga qytetarët e përhershëm dhe jo të përhershëm të Prishtinës, Institucionet shtetërore dhe institucionet ndërkombëtare që janë të vendosura në Prishtinë si dhe persona juridik dhe fizikë që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të Prishtinës.

Megjithatë edhe opsioni i dytë nuk i përgjigjet në tërësi specifikave që ka Kryeqytetit veçanërisht në fushat dhe kompetencat shtesë që duhet ushtruar si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

Opsioni i dytë ka kosto financiare shtesë ashtu siç është përcaktuar në tabelën për Përmbledhjen e Ndikimit Financiar.

Opsioni i tretë, trajton Prishtinën si njësi të veçantë të vetëqeverisjes lokale në aspektin organizativ si dhe në aspektin funksional.

Bazuar në këtë opsion të rekomanduar normohet statusi dhe organizimi i veçantë i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës Prishtinës i cili krijon bazë të qëndrueshme ligjore të funksionimit dhe organizimit të veçantë të Kryeqytetit në raport me njësitë tjera të vetëqeverisjes lokale. Ruhet sistemi një-shkallësh i vetëqeverisjes lokale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ashtu siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu zbatimi i opsionit të tretë definon adresën e qartë të përgjegjësisë jo vetëm për qytetarët e përhershëm të Prishtinës por edhe për qytetarët që janë të vendosur përkohësisht ose pranojnë shërbime nga organet aktuale të komunës.

Është me rëndësi t'i referohemi zhvillimeve të fundit në hapësirën evropiane, të cilat konfirmojnë trendin sipas të cilit, kryeqytetet e vendeve evropiane duhet të kenë një rol të veçantë qeverisës dhe zhvillimor, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë nevojave të qytetarëve në ofrimin e shërbimeve publike. Ofrimi i shërbimeve publike nga organet e Kryeqytetit, si kryeqendër administrative, diplomatike, arsimore, shëndetësore, sociale, urbanistike, bankare, etj, do të ketë efekt shpërndarës në fusha të ndryshme sektoriale dhe do të ndikojë në rritjen e efikasitetit dhe zgjerimit të shërbimeve cilësore për qytetarët si dhe institucionet shtetërore, institucionet publike, institucionet ndërkombëtare si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që veprojnë brenda territorit të Prishtinës.

Planifikimi i qëndrueshëm strategjik në fushat sektoriale lidhur me përgjegjësitë që ka Kryeqyteti do të ndikonte në avancimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale në ofrimin e shërbimeve bazuar në kërkesat e pranuar nga qytetarët e Prishtinës, institucionet si dhe grupeve tjera të interesit që veprojnë brenda territorit administrativ të Kryeqytetit.

Rregullimi ligjor i marrëdhënieve ndërmjet qeverisë qendrore dhe lokale është i rëndësishëm së veçantë marr për bazë projektet nacionale të cilat kanë efekt të gjerë për shtetin si dhe qytetarët e Republikës së Kosovës. Po ashtu organizimi i aktiviteteve shtetërore në fushën diplomatike, kulturore, bashkëpunimit rajonal dhe fusha tjera sektoriale, si dhe organizimin e festave shtetërore është e domosdoshme të ketë një bashkëpunim dhe bashkëveprim ndërinstitucional në mes të institucioneve shtetërore dhe organeve të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës/Prishtinës.

Krijimi i Zonës Metropolitane në bashkëpunimin të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës me komunat fqinje është i domosdoshëm veçanërisht në fushën e ofrimit të shërbimeve publike, zhvillimit socio - ekonomik lokal, transportit publik lokal, planifikimit të qëndrueshëm hapësinor, zhvillimin e turizmit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, zhvillimin e infrastrukturës

komunale, menaxhimin e mbeturinave, dhe fusha tjera sektoriale. Ky bashkëpunim është më se i domosdoshëm për të siguruar ofrim të shërbimeve publike me cilësi më të lartë dhe kosto financiare më të ulët. Po ashtu në të gjitha rastet bashkëpunimi duhet të jetë i formalizuar.

Opsioni i tretë ka kosto financiare shtesë ashtu siç është përcaktuar në tabelën për Përmbledhjen e Ndikimit Financiar, mirëpo krijon mundësi për gjenerim të të hyrave më të mëdha të Kryeqytetit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale.

Kosto financiare e përafërt e secilit opsion

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Opsioni 1				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0.00	0.00	0.00	0.00
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0.00	0.00	0.00	0.00
Financimi i pritur nga donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00
Opsioni 2				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0.00	3,644,000.00	3,644,000.00	3,644,000.00
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0.00	0.00	0.00	0.00
Financimi i pritur nga donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00
Opsioni 3				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0.00	4.728,000.00	4.728,000.00	4.728,000.00
Diferenca neto në gjenerimin e	0.00	0.00	0.00	0.00

të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00

Kapitulli VII - Konsultimi

Procesi i konsultimeve për zhvillimin e këtij koncept-dokumenti është zhvilluar në dy nivele, e para, konsultimi i brendshëm, dhe e dyta, konsultimi i jashtëm.

E para, konsultimi i brendshëm është realizuar me njësitë brenda Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe me përfaqësuesit e Komunës së Prishtinës për të reflektuar lidhur më përvojat e tyre sa i përket zbatimit aktual të legjislacionit për vetëqeverisje lokale si dhe domosdoshmërisë së zhvillimit të konceptit dokumentit i cili i paraprinë nxjerrjes së Ligjit për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinës. Po ashtu ka pasur një konsultim me organizata ndërkombëtare dhe vendore që merren me qeverisje lokale dhe përkrahin komunat aktualisht.

E dyta, para procedimit në Qeverinë e Republikës së Kosovës për miratim të koncept dokumentit do të konsultohen të gjitha institucionet relevante të Republikës së Kosovës, komunat si dhe organizatat e shoqërisë civile ashtu siç kërkohet me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

Kapitulli VIII - Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1: Ky opsion për mos ndryshimin e gjendjes nuk do të ketë përfitim por vetëm pasoja negative, për shkak të vështirësive në zbatim. Sa i përket pasojave negative, janë vështirësitë në organizimin dhe funksionimin e qëndrueshëm të Prishtinës, zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik, ofrimin e shërbimeve publike, sigurinë publike. Të gjitha institucionet shtetërore, komuna, përfaqësitë diplomatike, organizatat ndërkombëtare, personat fizik dhe juridik ndikohen në rast mos ndryshimit të gjendjes përkatësisht mos rregullimit specifik ligjor të Kryeqytetit.

Opsioni 2: Me këtë opsion do të kemi një organizim dhe funksionim më të mirë të Kryeqytetit mirëpo nuk i përgjigjet të gjitha specifikave që ka Kryeqyteti, veçanërisht në fusha sektoriale që bien në kompetencë të kryeqytetit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale.

Opsioni 3: Me këtë opsion krijohet qartësi ligjore në organizimin dhe funksionimin e Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, bashkëpunimin ndërinstitucional, ofrimin e shërbimeve publike efektive, planifikim strategjik të integruar si dhe respektim të standardeve bashkëkohore të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të Kryeqytetit.

Kapitulli IX: Rekomandimi

Me nxjerrjen e Ligjit për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës do të normohet statusi dhe organizimi i veçantë i Kryeqytetit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale. Pas miratimit të këtij koncepti nga Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të Programit Legjislativ në periudhën e K-4 të vitit 2015 do të përfshihet edhe hartimi i projektligjit për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës – Prishtinën. Kosto financiare e opsionit të rekomanduar është përcaktuar në Kapitullin VI të këtij koncepti.

Politika e re do të fillojë të zbatohet në momentin që hyn në fuqi Ligji për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës Prishtinën.

Kapitulli X: Komunikimi

Në një takim të përbashkët me ministritë sektoriale, komunat, shoqërinë civile veçanërisht organizatat që merren me vetëqeverisje lokale do të ketë një konsultim dhe informim rreth zhvillimit të politikës përkatësisht koncept dokumentit për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës Prishtinës, i cili do të mbahet në objektin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.